REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2019:299642

Datë: 07.12.2022

Numri i dokumentit: 03724408

C.nr.677/2019

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, në përbërje nga gjyqtari Hajrullah Aruqi, në çështjen juridike të paditësit F.S. nga fshati..., komuna Skenderaj, që e përfaqëson me autorizim V.Rr. avokat në Prishtinë, kundër të paditurës B.K.S me seli në Prishtinë, që e përfaqëson me autorizim E.M., për kompensim të demit material nga auto përgjegjësia, pas mbajtës dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor me pjesëmarrjen e palëve ndërgjygjëse, me dt.17.11.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET në tersi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.S. nga fsh.... komuna Skenderaj.

DETYROHET e paditura B.K.S., me seli në Prishtinë, qe paditësit F.S. ti kompensoj dëmin material, të cilin e ka pësuar me dt. 17.08.2019, në rrugën... në Skenderaj në automjetin e udhëtareve te markës –tipit "Mercedes" i vitit 2014 me targa te regjistrimit... me fajin e të siguruarit të paditurës, ne shumën prej 11.151,00 euro, me kamatë ligjore ne normën prej 8 %, duke e llogaritur nga dita e ushtrimit te padisë me dt. 30.12.2019, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, dhe atë për taksë për padi 100 euro, për një seancë 270 euro, për ekspertize te makinerisë shumen prej 150 euro, gjithsej shpenzime te procedurës 520 euro. Të gjitha shumat e lartcekura duhet te paguhen ne afat prej 15 dite nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcenim të përmbarimit.

Arsyetim

Paditësi në padinë e ushtruar në këtë gjykatë ka theksuar se me dt.17.08.2019 rreth orës 00:30 ne rrugën... në Skenderaj ka ndodhë aksident i komunikacioni rrugor me ç'rast është shkaktuar dem material dhe jo material. Pjesëmarrës në aksident ka qenë automjeti "A" për pasagjer, i markës "BMW" i tipit sport M me nr. te targave... të cilin ne momentin e aksidentit e ka drejtuar D.S., automjeti "B" për pasagjer, i markës "Mercedes" me targa..., të cilin e ka drejtuar paditësi F.S. pronar i automjetit. Se automjeti i paditësit ka qenë i siguruar dëshmohen me policen valide te automjetit .
Në këtë aksident paditësi ka pësuar lëndime fizike te natyrës se rëndë, frikë dhe dëme tjera. Menjëherë pas aksidentit ka marr ndihmën mjekësore në QE në Mitrovice ku janë konstatuar lëndimet e pësuara trupore dhe frika.

E paditura është e detyruar qe paditësit ti kompensoj dëmin në bazë te përgjegjësisë sepse i siguruari i saj është fajtori i vetëm. Te e paditura kemi ushtruar kërkesë për kompensim të dëmit por demin nuk e kemi realizuar.

2019:299643

I propozoi gjykatës qe pas administrimit te provave të detyrohet e paditura që paditësit ti kompensojë dëmin jo material për dhimbje fizike 5500 euro, për friken e përjetuar 5500 euro, për zvogëlim te aktivitetit te përgjithshëm jetësor 9000 euro, për shëmtim trupor 2000 euro, për dëmin material për shpenzime te shërimit 1500 euro, për kujdesin e personit te tretë 700 euro, për shkak te ushqimit të përforcuar shumen prej 600 euro, për rehabilitim shëndetësor 1154 euro, për zvogëlim te aftësisë punuese 8000 euro, dhe për dëm material në automjet shumen prej 19000 euro, te gjitha me kamatë ne normë prej 12 % sipas tarifës së OAK.

Në seancën përgatitore me dt.15.08.2022 palët ndërgjyqëse e arritën pajtimin gjyqësor, për dëmin jo material dhe material sa i përket dhimbjeve fizike, frikës së përjetuar dhe pjesës tjetër te dëmit qe i përket lëndimeve trupore në shumën prej 1200 euro dhe shpenzimet e procedurës të arritura. Pala paditëse përmes përfaqësuesit me autorizim propozoi vazhdimin e procedurës me nxjerrjen e provës me ekspertizë të makinerisë se inxhinierisë nga ing. S.B. për vlerësimin e lartësisë së dëmit në automjetin pronë e paditësit.

Pas marrjes se ekspertizës së makinerisë ndaj te cilës paditësi nuk pati vërejtje i propozoi gjykatës qe kërkesëpadinë ta aprovoi në tersi si te bazuar ashtu qe ti kompensohet dëmi në vlerën prej 11.151.00 euro siç është përcaktuar me ekspertizë me kamatën ligjore prej 8 % në vit, nga dita e shkaktimit të dëmit me dt. 17.08.2019.

I kërkoi shpenzimet e procedurës në lartësi prej 759 euro dhe atë taksë gjyqësore 100 euro, për përpilimin e padisë-ndryshimin 104 euro për përfaqësim në një seancë shumën prej 270 euro si dhe për ekspertizë te makinerisë shumen prej 150 euro.

E paditura me përgjigjen ne padi me dt. 29.07.2022 deklaroi se nuk e konteston bazën juridike të padisë por kontestuese mbetet vetëm lartësia e saj duke u bazuar në raportin fillestar policor, ngase përgjegjës ne shkaktimin e këtij aksidenti ka qenë vetura (A) dhe me ketë rast na takon legjitimiteti pasiv i palës se paditur. Me qellim te ekonomizimit te procedurës paditësit i ofroi ofertën për mbyllje te kontestit me marrëveshje gjyqësore, për lëndime shumen prej 900 euro, ndërsa për dëm ne automjet shumen pre 7000 euro.

Gjatë shqyrtimit kryesor mbeti pranë përgjigjes në padi, e kundërshtoi ekspertizën e makinerisë vetëm sa i përket shumes për TVSH-në si të pa bazuar, ngase nuk ka prova se kjo kategori është paguar dhe kërkoi nga gjykata përjashtimin e kësaj shume dhe sa i përket shpenzimeve të procedurës të ketë parasysh suksesin në procedurë dhe shpenzimet e paguara për lëndimet trupore.

Gjykata me qellim te konstatimit te drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike ne çështjen konkrete juridike, ne bazë te nenit 7 dhe 8 te LPK-së i nxori dhe i administroi te gjitha provat e shënuara në procesverbalin e seancës se shqyrtimit kryesor me dt. 17.11.2022 një nga një, dhe të gjitha se bashku duke i krahasuar njërën me tjetrën, nga të cilat rezultoi se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë.

Në mesë te palëve ndërgjygjëse nuk është kontestues fakti rreth përgjegjësisë se pjesëmarrësve në shkaktim te aksidentit nga se e paditura me përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor është deklaruar se nuk është kontestues fakti se i siguruari i saj është shkaktar i vetëm i aksidentit te trafikut qe ka ndodhë me dt. 17.08.2019 në Skenderaj dhe paditësit me të paditurën në seancën përgatitore me dt.15.08.2022 kanë lidhë pajtim gjyqësore për kompozim të dëmit për lëndime trupore dhe frikën në shumën prej 1200 euro dhe për shpenzimet e procedurës që kanë janë krijuar 104 për padi dhe për një përfaqësim në një seancë shumën prej 135 euro, gjersa kontestuese në mes të palëve mbeti lartësia e dëmit për automjetin e paditësit.

2019:299643

Për konstatim te lartësisë së dëmit në automjetin e paditësit te tipit " Mercedes" me targa te regjistrimit... është nxjerr ekspertiza e makinerisë nga eksperti S.B. nga Skenderaj. Eksperti në mendimin dhe konstatimin e tij të dt.17.08.2022 pas analizimit dhe vlerësimit te gjitha provave në shkresat e lëndës konstatoi se riparimi i automjetit (Teknik dhe ekonomikisht) është i arsyeshëm, prandaj ky automjet mund te riparohet dhe të kthehet në gjendjen e mëparshme (para aksidentit).
Automjeti – Mercedes ka pas dëm të madh material në anën e pasme majtas dhe pjesërisht brenda. Sipas analizave te rastit dhe studimit të lëndës eksperti ka arritë ne përfundim se shumica nga pjesët e dëmtuara kanë pasë nevojë te ndërrohen e disa te riparohen.
Automjeti ka qenë i përdorur rreth pesë vite (deri ne kohen e aksidentit), konstatoi se pjesët qe duhet të ndërrohen , llogariten si pjesë të reja me amortizim dhe origjinal nga prodhuesi, këto pjesë gjendën në dyqane për auto pjesë nga servisi i autorizuar në Kosovë apo porositen "online". Çmimet për pjesë janë marrë nga ekspertiza "D..." dhe janë të ngjashme me katalogun adekuat "E...". Automjeti i sipër cekur ka dëm në pjesë te jashtme te karrocerisë andaj dhe duhet te ngjyroset pjesërisht. Çmimit te pjesëve i është zbritur amortizimi për vite te shërbimit prej 20 %.
Pasi qe kemi në dispozicion ekspertizën e riparimit nga " D... " procesverbali nga BKS dhe fotot, konstatoi se pjesët e dëmtuara qe janë paraqitur në faqen tre te ekspertizës te gjitha korrespondonin më dëmin real në aksidentin e cekur.
Puna e dorës është llogaritur sipas serviseve te autorizuara në Kosovë te cilat merren me riparimin e automjeteve te tilla 25,00 euro në orë për të gjitha punët si: mekanike, karroceri, elektrike ngjyrosje etj. duke e marrë për bazë qe nevojiten edhe materiale te imta të tjera. Në fund eksperti erdhi në përfundim se pjesët që ndërrohen dhe puna për ndërrim – riparim te pjesëve kushton 8,900.20 euro, puna dhe materiali për ngjyrosje 550.0 euro, TVSH 18 % në shumen prej 1,701.20 euro.
Eksperti ka konstatuar se dëmi i përgjithshëm në automjet në kohen e aksidentit me TVSH e arrin vlerën prej11,151.00 euro.

Ndaj ekspertizës pala paditëse nuk pati vërejtje ndërsa e paditura u deklarua se vlerësimin e ekspertit e kundërshton vetëm sa i përket llogaritjes se vlerës së TVSH-së, nuk kërkuan sqarime nga eksperti në ekspertizë.

Gjykata e vlerësoi ekspertizën e makinerisë dhe e mori si provë te besueshme ngase i përmban te gjitha elementet e nevojshme te dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe përvojës së ekspertit në ketë fushë prandaj gjykata e mori si provë vendimtare mbi bazën e te cilës drejtë dhe real është vlerësuar lartësia e dëmit qe e ka pësuar paditësi në automjetin e tij.

Në dispozitat e nenit 183 të LMD-së shprehimisht është përcaktuar " *Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensoi dëmin përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tije* ". Po ashtu në dispozitat e nenit 159 paragrafi 1 të LMD-së thuhet " *Në rast te aksidentit të shkaktuar nga mjeti motorik në lëvizje qe është shkaktuar vetëm për faj te një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësi në bazë të fajit* ". Në rastin konkret dëmi material është shkaktuar me fajin e vetë te siguruarit te të paditurës, e cila është e obliguar qe ti shpërblej dëmin paditësit, në shumën e konstatuar ne ekspertizë pasi qe shkaktari i dëmit me të paditurën ka lidhë kontratën e sigurimit –policen nr. 19- 030 -13046 për mbulim e dëmeve cila ka qenë e vlefshme në momentin e shkaktimit të aksidentit, në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të nenit 3, 5 LSDA nr.04/L-018.

Gjykata i vlerësoi kundërshtimet e palës së paditur te cilat kanë të bëjnë me arsyetimin se e paditura ka për obligim ti kompensoi dëmin pa TVSH i cili kundërshtim nuk është i bazuar në ligjin nr. 05/L-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar nga se në dispozitat e nenit 2 paragrafin 1.2 thuhet "*TVSH-tatimi në vlerën e shtuar i cili përfshin aplikimin e tatimit në konsum për mallra dhe shërbime qe është saktësisht proporcional me çmimin e mallrave dhe shërbimeve dhe e cila*

2019:299643

llogaritet në ketë çmim sipas normës se aplikueshme , ngarkohet në fazat e ndryshme te prodhimit , shpërndarjes dhe ciklit jetësor te tregtisë së mallrave dhe shërbimeve qe ne funde bartet nga konsumatori i fundit " . Në dispozitat e nenit 2 paragrafi 2.7 shprehimisht është përcaktuar pasuria e cila është e paprekshme respektivisht ndaj te cilës nuk aplikohet TVSh ku shprehimisht thuhet "*Pasuria e paprekshme-patentat , te drejtat e autorit, licencat te drejtat ekskluzive dhe pasuritë tjera qe përbëhen vetëm nga te drejtat, por qe nuk kanë formë fizike*".

Nga dispozitat ligjore te cituara me lartë gjykata konstaton se tatimi në vlerën e shtuar i llogaritur nga ana e ekspertit është ne pajtueshmëri me ligjin ngase pjesët e blera për riparim te automjetit të me doemos i nënshtrohen TVSH sepse nuk hyjnë në kategorinë e mallrave që lirohen nga tatim në fjalë, prandaj kundërshtimi i të paditurës nuk është i bazuar dhe nuk është me ndikim që të vendosur ndryshe nga ajo qe është vendosur ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar si rezultat i provave të administruara është vërtetuar se e paditura është e obliguar që paditësit ti shpërblej demin material të shkaktuar në lartësinë e konstatuar me ekspertizë të makinerisë në shumën prej 11,151.00 euro sipas përgjegjësisë në shkaktim të dëmit. Sipas dispozitave të nenit 137 të LMD-së " *Dëmi është zvogëlim i pasurisë së dikujt (dëmi i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj(fitimi i humbur)si dhe shkaktimi tjetrit dhembje fizike etj..".*

Vendimi qe pala e paditur do ti bart shpenzimet e procedurës kontestimore ne shumën prej 520 euro është i bazuar në faktin se pala paditëse me arritjen e pajtimit gjyqësor është kompozuar për një seancë 135 euro dhe për padi 104 euro, ndërsa për shpenzimet e krijuara në vazhdim të kontestit është vendos sipas dispozitave te nenit 452 par. 2 i LKP-së, ndërsa vendimi qe shpërblimi i demit te paguhet me kamatën vjetore prej 8 % nga dita e ushtrimit te padisë është i bazuar ne dispozitat e nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 te LMD-së dhe Mendimit juridik për kamatën pjesa e tretë periudha e pagesës së kamatës XIV i Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265 të dt.02.12.2020.

Me sa u tha më lartë konform dispozitave të nenit 143 të LPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICE – DEGA NE SKENDERAJ,
DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM
C.nr.677/2019, me 17.11.2022

G j y q t a r i
Hajrullah Aruqi

UDHEZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa ne afatin prej 15 dite nga dita e marrjes se këtij aktgjykimi, nëpërmes kësaj Gjykate , për Gjykatën e Apelit Prishtine.